



22 mars 2024

KOMUNIKATË

Seanca e dytë (II) e Bordit të ZRRE në 2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) në mbledhjen e tij të dytë (II) për këtë vit, të mbajtur sot, më 22 mars 2024, ka miratuar të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) të operatorëve të Transmetimit/Tregut (KOSTT), Shpërndarjes (KEDS) dhe Furnizuesit me Shërbim Universal (KESCO). Vlera e përgjithshme e miratuar e MAR-it për periudhën rregullative prill 2024 - mars 2025 është vendosur të jetë 399.62 milion euro. Me këtë rast Bordi ka kërkuar nga operatorët që bazuar në të hyrat e lejuara, të dorëzojnë sa më shpejt që është e mundur kërkesat për tarifatat e reja të cilat do të miratohen në seancën e ardhshme të Bordit.

Në këtë seancë, Bordi ka shqyrtuar dhe miratuar kërkesën e Bursës Shqiptare të Energjisë për zgjatje të afatit të listës së tarifave të ALPEX për zonën e ofertimit të Republikës së Kosovës.

Bordi i ZRRE-së në këtë seancë ka miratuar edhe Bilancin Vjetor të Energjisë Termike për vitin 2024 për ndërmarrjet NQ Termokos dhe NQ Gjakova. Qëllimi kryesor i miratimit të Bilancit Vjetor të Energjisë Termike është që të projektoj përmbushjen e nevojave të konsumatorëve që furnizohen me energji termike, në sasi të mjaftueshme gjatë sezonës ngrohëse.

Në këtë seancë Bordi ka aprovuar 37 kërkesa të konsumatorëve për autorizim për vetë-konsum nga të cilat 11 vijnë nga ndërmarrjet dhe 26 nga personat fizik.

Pjesë e shqyrtimit nga Bordi kanë qenë edhe disa ankesa të konsumatorëve dhe çështje të tjera që ndërlidhen me funksionimin e sektorit si dhe të Zyrës së Rregullatorit për Energji.

Të gjitha vendimet e Bordit të ZRRE do të publikohen në faqen elektronike zyrtare të ZRRE www.ero-ks.org.